



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 18.03.2021, me fillim në ora 10.00. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t’iu përshëndes, nënkryetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i Draft rregullores komunale për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Rahovecit,**
3. **Shqyrtimi për dalje në debat publik të Draft rregullores komunale për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme komunale,**
4. **Shqyrtimi i Propozim vendimit për subvencionimin e lindjeve në QKMF në Rahovec,**
5. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Planit lokal për Deponinë e Mbeturinave të Ngurta,**
6. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Planit lokal për Deponinë e Mbeturinave të Vëllimshme,**
7. **Shqyrtimi i Propozim vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim – lokalit afarist personave fizik dhe juridik,**
8. **Informatë rreth formimit të komisioneve sa i përket pasurisë të Komunës së Rahovecit,**
9. **Informatë mbi pronat të cilat janë në mbrojtje të Kanionit të Drinit të Bardhë tek Ura e Fshejtë,**
10. **Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre,**
11. **Të ndryshme.**

PIKAT SHITESË

1. Shqyrtimi i Propozim vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbim të pronës publike komunale me pronë private për interes të përbashkët,
2. Shqyrtimi i Propozim vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatshkurtër.

Kryesuesi –Të nderuar kolegë kuvendarë, a pajtoheni që t'i kemi edhe këto dy pika shtesë. Kështu që e qes në votim rendin e ditës me pikat shtesë. Konstatohet se unanimisht aprovohet rendi i ditës me pikat shtesë. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar** – A ka dikush ndonjë vërejtje apo të shtojë dikush diçka rreth procesverbalit. Nëse jo atëherë e vë në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar e KPF-së, konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:
2. **Shqyrtimi i Draft rregullore komunale për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Rahovecit.**

Saranda Sallteku – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, besoj se materialin e keni marr me kohë për organizimin funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Rahovecit. Këtë draft rregullorë e kemi pasur në Kuvend në mbledhjen e dhjetorit ku edhe e ka marr aprovimin e Kuvendit për dalje në debat publik dhe tani i ka kaluar të gjitha procedurat dhe nuk kemi pasur ndonjë koment apo plotësim të draft rregullore. Ftoj të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa që pas shqyrtimit të aprovojnë këtë draft rregullorë.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për ju kryesues, nënkryetarin e Komunës, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët, përfaqësues të mediave dhe gjithë të pranishmit në sallë. E falënderoj drejtoreshën për sjelljen e kësaj draft rregullore, ku edhe unë desha të kontribuoj sa i përket kësaj pike, ku në fillim shkruan draft rregullorë 03/2020 dhe është e vërtetë se në mbledhjen e kemi mbajtur më 29.12.2020 por këtë material në e kemi të përgatitur për vitin 2021 dhe nëse sot e trajtojmë atëherë pyetja është se a duhet të ekzistojë data e sotit apo data e muajit dhjetor të vitit kaluar. Gjithashtu në faqen e dytë që lidhet me këtë, ku shkruan që Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më 29.12.2020, miraton këtë rregullorë për organizimin funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane. Unë mendoj se këtu është një lëshim që duhet të korrigjohet edhe të thuhet që Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 20.12.2020 merr vendim apo propozon për vënien në debat publik të kësaj rregullore. Pra, do të ishte mirë që për mbledhje të kuvendit me na ardhë me këtë përmirësim sepse nëse në njëherë kemi marr vendim atëherë nuk ka nevojë me marr vendim edhe për herë të dytë. Kështu që besoj që drejtoresha këtë e përmirëson edhe na sjellë për mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi – Faleminderit z. Fazliu, atëherë mëqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatohet se kalon për Kuvend pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. **Shqyrtimi për dalje në debat publik të Draft rregullore komunale për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme komunale.**

Mirsad Shala – Përshëndetje kryesues, i nderuar nënkryetar i Komunës, drejtor të drejtorive, anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe gjithë ju të pranishëm. Komuna e Rahovecit përkatësisht kolegji i zyrtarëve ligjor në bashkëpunim me Ministrin e Pushtetit Lokal e ka hartuar një draft rregullorë në nivel të Kosovës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës më me pak se një vit. Kjo ka ardh si kërkesë e ligjit për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim edhe rregullore 09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës respektivisht nenit

7 te rregullores që i përcakton se cilat janë pronat e paluajtshme të komunës që jepen më pak se një vit. Kjo rregullore përbëhet nga 3 kapituj, ku në kapitullin e parë përcaktohen dispozitat e përgjithshme ku në nenin 5 të kësaj rregullore për dhënien në shfrytëzim janë caktuar pronat e paluajtshme të komunës që mund të jepen në shfrytëzim për më pak se një vit, që janë në harmoni me rregulloren për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme. Në këtë rregullore janë caktuar hapësirat publike që janë parqet, sheshet, bulevardet, shtëpitë e kulturës, kinematë, teatrot, hapësirat publike para lokaleve, lokalet në pronësi të komunës për ato lokale që janë lëvizëse, hapësirat publike rreth vend punishteve. Në këtë rregullore janë të përcaktuara edhe kriteret që duhet të jenë për dhënien në shfrytëzim, procedurat të cilat parashihen për dhënien në shfrytëzim të një prone të paluajtshme për më pak se një vit, komisionet të cilat duhet të formohen, ankesat, komisionet për ankesa si dhe obligon në fund nënshkrimi i kontratës me palën të cilën e fiton të drejtën në shfrytëzim. Në fund është dispozita e dytë, mbikëqyrja e kontratës si dhe dispozitat përfundimtare. Komuna e Rahovecit ka marrë pjesë në kolegjiunin e zyrtarëve ligjor dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal që është bërë një rregullore unifikuuese në gjithë Kosovën dhe kjo është formë që është bërë në nivel të Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Rasim Fazliu – E falënderoj z. Shala për prezantimin e kësaj pike, e draft rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës. Fillimisht do të ndalesha në faqen 2, neni 2 të fushëveprimit, dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nga organet e komunës dhe do të ishte mirë që pas presjes të vendoset “për” personat fizik dhe juridik. Pastaj faqe 5, neni 8, tek pika 2.2 për dhënien në shfrytëzim të objekteve kulturore, rinore dhe sportive. Pastaj tek neni 6, dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për organizatat e shoqërisë civile d.m.th. këtu neni 6 pika 4 thotë vendos drejtori faktikisht përjashton shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlerësues. Ndërsa unë mendoj që nuk do të ishte kontribut që edhe komisioni vlerësues pavarësisht drejtorit që merr vendim me bashkëpunua edhe me komisionin edhe me dhanë kontributin në këtë drejtim nëse nuk do të ishte pengesë. Pastaj, do të ndalem tek afatet, ku thotë se komisionet për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës më pak se një vit d.m.th. propozohet për një vit me mundësi vazhdimi edhe për një vit ndërsa komisioni për shqyrtimin e ankesave propozohet për dy vite me mundësi vazhdimi edhe për dy vite tjera. Pra, edhe këtu do të ishte mirë me i harmonizue këto që nëse është njëri për një vit atëherë edhe vazhdimi të jetë për një vit apo nëse është për dy vite atëherë edhe tjetri të bëhet për dy vite, pasi do të ishte edhe më e logjikshme kështu që unë propozoj të bëhet për një vit apo për dy vite. Pra, ashtu siç e aprovon Kuvendi i Komunës, por, assesi njëri për një vit kurse tjetri për dy vite, pra të dy komisionet që ta kenë të njëjtin mandat.

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Edhe unë desha të japë pak kontribut, ndoshta më shumë kam edhe si lloj pyetje, por, megjithatë e falënderoj drejtorin për gjithë këtë që e ka sjellë para neve. E kam fjalën për pronën publike të cilat janë kryesisht prona të vogla nëpër fshatra edhe qytet që i shfrytëzojnë njerëzit për nevoja të ndryshme. Unë kisha pas një propozim për këtë draft rregullore që rreth rrotullimet parqet e qytetit, por, edhe nëpër fshatra do të ishte mirë me ju ofruar qytetarëve që të bëjnë reklamimet e firmave të tyre në kompensim të qirasë për mirëmbajtjen e atij vendi ku ata i vendosin reklamat e tyre p.sh. të dy rreth rrotullimet që nuk mirëmbahen edhe mbillen në ato vende mirëpo për shkak të mosmirëmbajtjes ato thahen. Kështu që nëse atyre ju japim që me i bo reklamimet e firmave atëherë ata edhe do të kujdesen për mirëmbajtjen e tyre me bime të ndryshme që i mirëmbajnë me kushtin që ai mos me pague taksë për atë vend që e ka marrë në shfrytëzim. Kështu që, do të ishte mirë me sensibilizua opinionin që t’i marrin këto vende dhe t’i shfrytëzojnë dhe njëfarë mënyrë të zbukurojnë edhe qytetin. Pra, do ishte mirë për të gjitha këto vende duhet të merren nga njerëzit që dëshirojnë me i reklamua firmat e tyre me mundësinë e mirëmbajtjes së asaj hapësirë si formë e kompensimit.

Mirsad Shala – Faleminderit kryesues, po lidhem me pyetjen e parashtruar nga z. Rasim Fazliu, tek neni 6 është dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për organizatat e shoqërisë civile. Në nenin 2, dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për organizatat e shoqërisë civile jepet nga 1 deri në 10 ditë. Pra, ky është afati, për shkak se ka ndonjë organizatë të shoqërisë civile që kërkon p.sh. Feha kërkon me bo një ekspozim edhe jepet për 10 ditë, kështu që kjo është çështja se pse është shkuar me vendim të drejtorit për me i dhanë në shfrytëzim për këto 10 ditë. Por, nëse kërkohet më tepër se 10 ditë

atëherë normalisht duhet të shkohet përmes komisionit. Pra, kjo është çështje që është shkruar me vendim të drejtorit për me dhanë në shfrytëzim për ato ditë (1-10 ditë) sa ata kanë nevojë, shoqëria civile apo për promovim të ndonjë aktiviteti të cilën e kanë ata. Ne kemi bërë kështu për shkak se komisioni me pas një mandat më të gjatë që mos me ndryshua mirëpo ajo varet edhe nga ju se si ju e vlerësoni. Po ashtu, edhe pyetje tjetër e parashtruar nga z. Dervish Çadraku, në hapësirat publike, në rregullore kemi cekur këto hapësira publike siç janë të përcaktuara me rregullore për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale 09/2020. Për këto rreth rrotullime ndoshta më mirë do të merrni shpjegim nga Drejtori i Shërbimeve Publike z. Përparim Krasniqi, pasi që në momentin që ata bëjnë pano reklamuese ata do te paguajnë në drejtorinë e Shërbimeve Publike me tarifat që janë. Mirëpo në këtë rregullore nuk kemi mundësi për shkak se këto janë kufizime që na jep në bazë të rregullores 09/2020.

Përparim Krasniqi – Me rregulloren për sipërfaqe publike pra shfrytëzimin e hapësirës publike me kontratë 1 vjeçare reklamimin ne te gjitha pjesët e sipërfaqes publike mirëpo ka disa kriteret ne rreth rrotullime për shkak te pamjes që lëvizin veturat e përcakton diametrin e vendosjes se reklamimit ne rreth rrotullime. Nuk lejohen reklamimet e mëdhaja për shkak se dezorienton trafikun pasi edhe ne kontratat për mbajtjen e hapësirave publike i kemi rreth rrotullimet për mirëmbajtje pasi nuk mundemi me lidhë edhe nuk mundemi me i dhanë pa pagesë nëse bën kërkesë dikush, pra pa pagesë nuk lejohet me bo reklamim d.m.th. ajo publiko privat por nëse donë me bo pa pagesë për me mirëmbajt rreth rrotullimin e hapësirës publike.

Dervish Çadraku – Ndoshta edhe nuk jemi kuptuar, pasi atë e përkthen në para sepe nuk jeni në gjendje me i mirëmbajte parqet, pasi më shumë se gjysma kanë qenë të dëmtuara dhe shumë bimë të mbjella janë tharë dhe të mbjella pa kriter. Kështu që kushdo që e merr në mirëmbajtje atëherë është i detyruar edhe me u kujdes dhe e mirëmbajte atë hapësirë për periudhën e caktuar.

Përparim Krasniqi – Në bazë te ligjit nuk lejohet një biznes me bo këso marrëveshje pa pagesë pasi nuk na lejon ligji që me dhanë pa pagesë ne këmbim te mirëmbajtjes. Pasi ne kemi kontratat dhe ne duhet me rrit nivelin e përgjegjësisë kompanive që e mirëmbajnë rreth rrotullimet, pasi dihet që shumë rreth rrotullime nuk kanë ujë për ujitje të vendosura në sistem edhe sigurisht që bari thahet. Mirëpo sikur te kish pasur ujë të vendosur aty edhe mundësia për mirëmbajtje do te ishte më e mirë pasi e kishe forcua kriterin edhe e kishin mirëmbajte edhe ishin dok me bukur. por në mungesë të ujit atëherë këto rreth rrotullime nuk duken të gjelbra pasi nuk kanë ujë dhe kjo ta jep përshtypjen se nuk po mirëmbahen sa duhet. Përndryshe, Komuna e Rahovecit i ka në menaxhim mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe rreth rrotullimeve, mbjelljen e luleve dhe gjitha gjërat që i ka sipas kontratës.

Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor për sqarimin, kështu që konstatoj se edhe pika e tretë e rendit te ditës, kalon për kuvend. Kalojmë ne pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Propozim vendimit për subvencionimin e lindjeve ne QKMF në Rahovecit.

Samir Mustafa – Përshëndetje për te gjithë. Duke u bazuar ne nenin 13/58 te ligjit për vetëqeverisje lokale, Kryetari i Komunës i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit që të merret vendimi me të cilën gratë, nënat të cilat lindin në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare të subvencionohen në shumën prej 200 euro mjete financiare. Subvencionimi do te bëhet nga mjetet vetanake të Komunës së Rahovecit respektivisht nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale. Ftoj që ta miratoni propozim vendimin.

Florida Bajraktari – Përshëndetje për ju kryesues, nënkryetarin, anëtarët e KPF-së, drejtorët dhe gjithë të pranishmit në sallë. Më erdhi mirë që e pash këtë propozim që na ka ardh në rend të ditës dhe mesa më kujtohet këtë propozim ia kam bërë kryetarit në një prej mbledhjeve të Kuvendit, që të gjitha gratë që lindin në QKMF-në e Rahovecit te subvencionohen me një shumë simbolike dhe kryetari me patë premtuar se sipas mundësive do t'i shqyrtojë dhe do ta bëj, kështu që e ka mbajtur fjalën dhe e falënderoj për veprimin e bërë. Unë sigurisht që do ta përkrahi këtë propozim, pasi si shumë sa do e vogël që është, do të ju ndihmoj nënave që lindin fëmijë. Por, si propozim shtesë mendoj se është mirë që pa marr parasysh se ku lindin gratë e Komunës tonë të subvencionohen qoftë edhe ne vende tjera nëse lindin por dihet se janë të komunës tonë dhe do të ishte mirë të subvencionohen me këtë shumë.

Dervish Çadraku – Ky propozim është shumë i mirë dhe i mirëseardhur dhe befasi e këndshme për mua por mendoj që do te ishte mirë që drejtori për mbledhjen e ardhshme me sjellë arsyetimin se pse dëshiron me bë

këtë punë edhe ky arsyetim përmbledhet me numrin e lindshmërisë brenda vitit. Sa ka rënie të natalitetit në komunën tonë gjatë këtyre viteve dhe pastaj shuma prej 200 euro është tepër simbolike dhe nënat dhe gratë tona nuk kanë nevojë për simbolika por kanë nevojë me i kompensua në njëfarë mënyre se ka shumë shpenzime dhe sigurisht se është një lloj shtytje për me rritë natalitetin. Kështu që unë propozoj që kjo më së paku të jetë 500 euro e sigurisht që edhe mbledhjen tjetër do ta përsëris, gjithmonë konform numrit të lindjeve brenda vitit që të jetë 500 euro pasi me shumën e propozuar nga drejtori është jo shumë serioze.

Fehmi Cena – Përshëndetje për te gjithë juve. Mendoj se si iniciative kjo e drejtorisë së shëndetësisë që të stimulohen gratë që të lindin në QKMF në maternitetin tonë në Rahovec me shumën prej 200 eurove. Mendoj se është iniciativë e qëlluar dhe siç u potencua nga parafolësit e kemi cekur edhe si delegatë më herët këtu pasi ka qenë kërkesë. Kështu që, mirë është që po bëhet, por, natyrisht që duhet edhe disa sqarime dhe plotësime që kur të bëhet të jetë e pranueshme jo vetëm për ne delegatët, për femrat, gratë por në përgjithësi për qytetarët e komunës tonë e ndoshta edhe më gjerë. Qartësia është se na duhet qëllimi në këtë rast sepse po ceket vetëm për gratë që lindin në maternitetin e QKMF-së në Rahovec por ne kemi edhe gra që lindin edhe jashtë maternitetit, pastaj kemi gra që vijnë aty vizitohen edhe kërkojnë me lind mirëpo me indikacion të caktuar për lindjet që parashihen se do të jenë më të vështira apo lindjet e para që parashihen se janë më të vështira pasi edhe vet mjeku që punon aty i referon të shkojnë në klinika regjionale si në Gjakovë apo Prizren çka do të ndodhë me ata. Pastaj, nëse flasim për natalitetin, duhet pak me stimulue natalitetin atëherë duhet me qenë ndryshe sepse do të duhet të stimulohen të gjitha gratë ose me çmim të njëjtë apo me çmim më të ulët. Mendoj se çmimi 200 euro megjithëse mua më duket i arsyeshëm për fillimin sepse ne duhet të kemi parasysh buxhetin, sa do t'i kushtoj komunës edhe pajtohem me Dervish Çadrakun që tha për mbledhjen e ardhshme do te ishte mirë që me ditë afërsisht sa është numri i lindjeve që bëhet aty dhe sa është numri i lindjeve në nivel të komunës sepse kjo mund të jetë joshëse në të ardhmen që të ketë më shumë punë aty dhe më shumë lindje e sigurisht se do t'i kushtojë buxhetit të komunës dhe pastaj a do të ishte në gjendje komuna me përballua deri në fund. Pastaj, çka do të ndodhë me gratë që vijnë edhe lindin nga komunat tjera pasi kemi raste edhe prej Malishevës që vijnë edhe lindin në maternitetin tonë, a do të stimulohen ato edhe pse nuk janë qytetare të komunës tonë. Pastaj, do të ishte mirë një debat më i gjerë brenda kësaj kohe deri në mbledhjen e kuvendit e sidomos me repartin, me punëtorë, me gjinekolog dhe mami që janë me përvojë që të bisedohet edhe me ata sepse ndoshta do t'i ngarkon me një punë më të madhe dhe sa janë në gjendje me përballue, kështu që të merret edhe mendimi i tyre edhe rreth çmimit edhe rreth specifikave që unë i përmenda, se duhet të shikohet edhe ajo që ne e quajmë mundësi e barabartë dhe të mos kemi pastaj ndonjë shtresë që me u ndjerë e diskriminuar se pse ata paguhën kurse ne nuk paguhemi. Pra, të gjitha këto duhet të shqyrtohen deri ne mbledhjen e ardhshme të sqarohen në mënyrë që kur ta marrim një vendim sigurisht se do te jemi pro kësaj pasi kjo i konvenon edhe natalitetit por edhe maternitetit aty sepse vërtet ka rënë puna shumë.

Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor për sjelljen e këtij propozimi, vërtetë shuma sado që duket që është simbolike prej 200 euro, por mendoj se është një shumë jashtëzakonisht e mirë për fillim duke pasur parasysh edhe të hyrat që i kemi nga buxheti i komunës dhe krejt këto kanë një rrjedhje e cila ka një kosto, por unë e falënderoj shumë që edhe komuna jonë të fillojë subvencionimin e lindjeve të grave dhe nënave tona. Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatoj se kalon për kuvend edhe pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë ne pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Propozim vendimit te Planit lokal për Deponin e Mbeturinave të Ngurta.

Përparim Krasniqi – Ne këto dy draft rregullore i kemi kalua te gjitha procedurat dhe tash ka kalua edhe debati publik dhe është marr vendim ne kuvend pasi te gjitha procedurat janë ndjekë dhe nuk kemi pasur ndonjë vërejtje apo sugjerim lidhur me draft rregullore. Kërkoj nga ju që të shtyhet ne kuvend dhe te merret vendimi për aprovim për te dy draft rregulloret për shkak se shkojnë paralel dhe nuk janë të ndara. Kështu që nëse keni diçka rreth kësaj pike ne do te jemi këtu për të ju përgjigjur.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, e tha edhe drejtori se e kemi shqyrtuar edhe njëherë dhe ka kaluar edhe përmes debatit publik dhe tash jemi pranë momentit kur duhet te marrim vendim për mbledhjen e radhës së kuvendit. Unë për më tepër desha me pyet drejtorin pasi në fillim shkruan vendim për miratimin e planit lokal për menaxhimin e mbeturinave te ngurta. Kurse pika 2, thotë shtojcë e këtij vendimi është edhe

plani lokal për menaxhimin e mbeturinave të ngurta. Kështu që shtrohet pyetja se çfarë kuptimi ka pika e dyte nëse në titullin e kemi ashtu, pasi thotë për miratimin e planit lokal për menaxhimin e mbeturinave të ngurta. Pra, këtu duhet të shtohet ndonjë plan i vjetër nëse ka qenë i veprimit ose të hiqet krejt. Kështu që kërkoj nga ju që të jepni sqarimet e duhura për këtë.

Përparim Krasniqi – Sipas Zyrës Ligjore, me vendimin e parë për shkak të ligjshmërisë duhet me dërgua në Ministrinë e Pushtetit Lokal për ligjshmërinë e këtij vendimi edhe pjesa e dytë është shtojca që i bashkëngjitet ky plan draft këtij vendimi edhe dërgohet. Kështu që për këtë arsye me siguri e kanë paraparë që dy pika me shkua atje për ligjshmërinë. Pra me shume për çështje teknike duhet me shkua paralel edhe vendimi edhe plani.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor për sqarimin, meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatoj se kalon për kuvend edhe pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Planit lokal për Deponinë e Mbeturinave të Vëllimshme.

Përparim Krasniqi – Është i njëjti vendim për shkak se shkon paralel, pasi që komuna e Rahovecit nuk ka pasur me herët plan dhe kjo është për herë të parë. Kështu që jemi munduar për herë të parë me përfshi komunën e Rahovecit me mirëmbajtjen e hapësirave publike që përmes këtyre planeve t'i mbërrijmë edhe disa qëllime që të fitojmë edhe donacione tjera në kuadër të këtyre planeve, pasi që është edhe një lloj kriteri që kërkohet nga Ministria e Mjedisit që me i kalua këto plane dhe shpresoj që Komuna e Rahovecit edhe në vitet në vazhdim të përfshihet në mjedis të pastër edhe të jemi si komunë ekologjike.

Fehmi Cena – Unë kam diçka të veçante me shtua rreth këtyre planeve por dua të them se ne i kemi diskutuar edhe ne mbledhje të mëhershme dhe kemi dhënë kontributin tonë në propozimin për ndryshime. Mendoj që është punë e mirë që komuna jonë megjithatë po i bën këto dy plane edhe i konsideroj këto dy plane si strategjike të komunës. Kështu që, nëse bëhen këto plane mirë dhe punohet sipas këtyre atëherë komuna ka mundësi pastaj edhe me thithë edhe donacione edhe nga niveli qendror por edhe nga donatorët e jashtëm. Kështu që, uroj të kalojnë kështu siç janë edhe ne me i kalua ne kuvend për aprovim.

Kryesuesi – Faleminderit z. Cena, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatojmë se kalon për kuvend edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i Propozim vendimit për miratimin e vendimit paraparak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim- lokalit afarist personave fizik dhe juridik.

Artan Asllani – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Para jush e keni një propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Rahovecit e cila gjendet me saktësisht në lokalit të ish ndërmarrjes publike transportuese, tash veçse me vendim të kuvendit është bërë ndërmarrje publike me numër të parcelës P – 71510057 – 01789-2 me hapësirë prej 4815 m². Qëllimi i dhënies në shfrytëzim është vetëm hapësira prej 268 m². Për me shume informacione e keni edhe materialin para vete, kështu që për çdo sqarim jemi këtu.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin për këtë propozim që na dha këtu. Në pikën 1 është mirë e precizuar ku thotë që ky lokal afarist jepet në shfrytëzim afatshkurtër nga 1-15 vite, gjë që është shumë në rregull edhe sipas ligjit. Pastaj kthehemi në pikën 4 të këtij propozimi ku thuhet afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës – lokalit afarist në shfrytëzim të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi është afatshkurtër në periudhën prej 10 vite. Unë edhe më herët i kam propozuar drejtorit që këtë çështje duhet me ja lanë kuvendit pasi është edhe kompetencë e kuvendit pasi jemi në anëtarët e kuvendit që vendosim por këtu prapë duhet me shkrua prej 1-15 vite pastaj në diskutimet që bëhen në kuvend edhe në qëndrimet që merren atëherë kuvendi mundet me bo qoftë 1,7,10 aq sa donë, por këtu të rregullohet kjo të thuhet prej 1-15 vite kurse drejtori kur del me propozua mundet me than se ne si qeveri komunale apo si drejtori ju sugjeroj me shkua deri në 10 vite apo 15 vite por përndryshe si dokument me na ardh ashtu siç duhet.

Artan Asllani – Është e vërtetë se shume herë e kemi debatuar për këtë pikë e konkretisht te pika e dytë mirëpo sipas zyrtareve të Zyrës Ligjore kjo pikë nuk mundet me mbet sikur te pika e 1, për shkak se vet fakti tregon se ne mundemi me qitë një përcaktim por jo me marr vendim, pasi çdo herë mbetet si propozim i qeverisë e me pastaj mundemi me lanë sa dëshiron asambleja e kuvendit mirëpo nuk guxon me mbet e thatë nga 1-15 vite, për shkak se edhe vet ligji për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale është i përcaktuar

për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër nga 1-15 kurse te pika e dytë patjetër është obligative si drejtori me qitë për sa vite.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sqarimin, atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, konstatojmë se kalon për kuvend pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Informatë rreth formimit të komisioneve sa i përket pasurisë së Komunës së Rahovecit.

Artan Asllani – E kemi një informatë rreth aseteve dhe pasurisë së Komunës së Rahovecit, ku jam munduar që në këtë informatë të bëj një përmbledhje në vija të trasha për shkak të pamundësisë që ta zgjerojmë pak më tepër. Gjatë vitit 2020 janë formuar disa komisione që kanë të bëjnë me pasuritë financiare apo edhe jo financiare dhe pasuritë e paluajtshme të Komunës së Rahovecit e komisionit për tjetërsimin e pasurive dhe asgjësimin e pasurive. Në tabelën e parë është puna që është bërë për këto asete për periudhën janar – dhjetor të përshkrimit ku gjatë regjistrimit mbi 1000 euro janë afërsisht 339 lëndë me vlerë prej 7,011,403,23 cent. Në regjistrimet më pas se 1000 euro bëhet fjalë për 1474 lëndë dhe gjithsej 1813 lëndë me vlerë prej 7,130,192,091 cent. Ndërsa në tabelën e dytë sipas grafikës janë të përshkruara gjendja e aseteve me pak se 1000 euro sipas nën kodeve deri më datën 31.12.2020, nuk po i lexoj tani për shkak se i keni të gjitha në materialin që keni para vetes. Pra, bëhet fjalë për përshkrimin, artikujt, vlerat, pajisjet edhe vet sistemi të E-pasuria dhe te bilanci i jep emërtimin e këtyre nën kodeve. Ndërsa në tabelën në vijim janë të paraqitura në total regjistrimet në vlerë mbi 1000 euro sipas klasave të pasurisë të regjistruara nga viti 2000 – 2020. Gjithashtu e kam thënë nga viti 2018 e deri më tani një hap i veprimit të mirë që ka ndodhur në drejtorin e Ekonomisë është edhe regjistrimi i aseteve komunale për shkak se ka qenë një ngecje në këtë drejtim dhe që sa vite nuk kemi ndonjë rekomandim nga auditorët qoftë të brendshëm apo të jashtëm rreth regjistrimit të pasurisë së komunës së Rahovecit. Në tabelën e tretë janë të përshkruara, përshkrimi prej 1-23 dhe emërtimet e nën kodeve dhe vlera e përcaktuar e tyre. Kështu që keni diçka rreth kësaj informate, do të jem në dispozicionin tuaj me ju dhanë përgjigje.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, kalon për kuvend edhe pika e tetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Informatë mbi pronat të cilat janë nën mbrojtje të Kanionit të Drinit të Bardh tek Ura e Fshejtë.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, kolegë drejtor, anëtarë të KPF-së. Para jush keni një dokument i cili bazohet në dokumentin që është një vendim i komunës së Rahovecit i cili është nxjerrë pikërisht për këtë sipërfaqe ku precizohet saktë se cili është sipërfaqja e mbrojtur me zonë të ngushtë dhe zonë të gjerë. Ne i kemi kontrolluar parcelë për parcelë të gjitha parcelat që janë në këto dy zona kadastrale në Xerxe dhe në Gexhë dhe kemi bërë një listë me emrat e pronarëve që kanë prona në këtë zonë që është e mbrojtur me vendim si zonë e mbrojtur e Kanionit të Drinit të Bardh tek Ura e Fshejtë si monument natyror. Përveç kësaj këtu mundet me pas edhe dikush tjetër pasi këtu shitblerja në këtë zonë nuk është e ndaluar edhe pse në këto parcela ka edhe prona shtetërore gjithashtu edhe private, kështu që njerëzit kanë ble edhe kanë shitë mirëpo nuk e kanë krye trashëgiminë, kështu që te na figurojnë këta emra të këtyre pronarëve që ju i keni para juve, nëse nuk kanë ardh te na me kontratë me ekzekutue edhe parcelat të cilat ju i keni para vetes që figurojnë parcela shtetërore që ka pasur konteste pronësore në disa prej tyre dhe ata me vendim të gjykatës i kanë fitue këto të drejta dhe i kanë sjellë te na për ekzekutim d.m.th. ka parcela që janë ndarë pastaj për 1,2,3 që mundën me figurua edhe ndonjë pronar tjetër privat që nuk është këtu në këtë sipërfaqe. Ky vendim është në fuqi dhe ne e kemi kontrollua parcelë për parcelë dhe këto janë emrat e para disa ditëve që janë nxjerrë që figurojnë te na si pronar të këtyre pronave që gjenden në këtë zonë.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin pasi kjo ka qenë gjithashtu një kërkesë që të dihen pronarët e pronave që janë në atë territor të Zonës së Mbrojtur edhe është mirë që i ka sjellë këtu. Drejtori ishte shumë i qartë pasi deklaroi se këta janë emrat në listën kadastrale mirëpo besoj drejtor që realiteti ka ndryshua tani me siguri sepse ka njerëz që kanë ble prona mirëpo nuk e kanë bërë përkthyer në emër të tyre, mirëpo ajo është çështje që realisht nuk kemi çka me bo ne, kështu që edhe njëherë e falënderojmë drejtorin dhe vetëm desha një pyetje me bo për drejtorin pasi ne faqen e tretë tek këto sipërfaqe „hh,, që me sa e di unë është hektar dha tash te marrim shembull Korodona sh.p.k. për 9 vite që ka marr qira dhe në fund totali po del 88,177 hektar kështu që ne e dimë sipërfaqen e komunës së Rahovecit sa është, kështu që do të ishte mirë me na dhanë sqarime apo këta numra p.sh. numri kadastral 824-0, 3633 hektar,

mendoj se këtu është ndonjë gabim dhe duhet me u cekë këtu p.sh. 3 hektar e disa ari, por besoj që drejtori na sqaron këtë se çka është sepse po na dalin shume hektar, pasi kjo është në vazhdimësi në krejt materialin edhe në këtë zonën kadastrale në Xërxë është e njëjta gjë, pra sipërfaqja lartë është e shprehur në hektar por numrat nuk e di sa janë ne rregull nëse vërtetë janë hektar sepse mendoj se dalin shume hektar.

Afrim Oruqi – Është e vërtetë se këtë material e kanë përgatitur gjeodetë por e kanë parasysh se i kuptojnë edhe të tjerët. Kjo nuk pasqyron për parcela tjera pasi kemi edhe parcela te vogla te Korodona që nuk është me e madhe 4 ari edhe nuk ka te bëjë me këtë. Krejt sipërfaqja e kësaj parcele që janë me qira është 8 hektar 81 ari 77 m² d.m.th. kjo nuk vlen për parcela tjera që janë me numra 3 shifror, vlen për parcela te mëdhaja kështu që ne total sipërfaqja e privatizuar për 99 vite, qirambajtje Koradona sh.p.k është 8 hektar 81 ari 77m², kështu i kanë përsërit edhe për sipërfaqe tjera, vlen edhe për pronaret privat edhe ne Xërxë, Gëxhë edhe te prona shtetërore ku është.

Rasim Fazliu – Unë mendoj që kjo ,, h,, të hiqet krejt edhe për mbledhje te kuvendit të vjen e rregulluar.

Kryesuesi- Faleminderit z. Fazliu, atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar rreth kësaj pike, kalon për kuvend edhe pika e nëntë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, te nderuar kuvendarë para jush keni një informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre. Këtë informatë e kemi sjellë edhe viteve te kaluara dhe nuk dallon shume prej informatave te viteve te kaluara fatmirësisht edhe pse ka padi karshi pronave publike mirëpo ato nuk po përfundojmë fatmirësisht mirë edhe sipërfaqet e menaxhuara prej komunës se Rahovecit përafërsisht janë te njëjta. Ne kemi prezantuar objektet d.m.th. shkollat cila është sipërfaqe ne nivele te komunës, ato që janë prona shtetërore por që janë ne menaxhimin e shkollave e aty hyjnë çerdhet, shkollat profesionale, shkollat fillore, objektet kulturore, palestra sportive dhe janë te prezantuara edhe me sipërfaqe dhe hyjnë ne menaxhimin e drejtorisë se kulturës pastaj kemi objektet e shëndetësisë, QKMF-së, objekte komunale pastaj prona komunale te cilat para disa jave agjensioni kadastral ka marr një vendim dhe i ka unifikuar emërtimet dhe tash nuk mundemi me gjet prona komunale ne certifikatë si pronë shoqërore, pronë publike, pronë shtetërore te Kosovës KK-Rahovec pronë shtetërore Republika e Kosovës, pra krejt këto i kanë bo bashkë dhe kanë bo mirë që i kanë bo kështu dhe tash na del se çka do që ka te bëjë me pronë shtetërore, na del vetëm komuna e Rahovecit. Ne i kemi prezantuar edhe me zona kadastrale qysh i kemi pronat ne nivel komune, i kemi zone për zone sa i kemi ne Rahovec, Brestoc, Hoçë te vogël që gjithsej janë 34 zona ne përgjithësi ne nivele te Komunës te Rahovecit dhe sipërfaqet janë te prezantuara për secilën zonë kadastrale që i kemi në menaxhim. Ka prona tjera që nuk menaxhohen prej neve por prej agjencioneve tjera qofshin ato shtetërore dhe ka edhe institucionale që i menaxhojmë dhe i privatizojnë dhe ne nuk i pasqyrojmë këtu sepse nuk menaxhojmë me to.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë meqë nuk kemi te lajmëruar për këtë pikë, kalojmë ne pikën e parë shtesë.

11. Kërkesë për dhënien e pëlqimit për këmbim të pronës në zonën kadastrale në Rahovec.

Afrim Oruqi – Para jush keni një propozim për marrjen e pëlqimit për këmbim të pronës private me pronë publike. Këtë pikë e kemi pasur edhe muajin e kaluar dhe kemi kërkuar nga ju që me shpallë zonë me interes te përgjithshëm. Kjo është zonë kadastrale ne Rahovec, përafërsisht është pompa e benzinës „Kosova Petrol,, dhe bëhet fjalë për 81m². Ne muajin e kaluar bashkërisht e kemi shpallur zonë me interes te përgjithshëm dhe e kemi sjellë me vonës sepse e kemi prit ligjshmërinë e MAPL-së dhe kjo na ka ardhë pasi që juve materiali ju është dërguar edhe po kërkojmë prej juve që të na jepni pëlqim për këmbim te pronës publike me pronë private për hapje te rrugës ne sipërfaqe te njëjtë te këmbëjmë sipërfaqe te pronës private me pronë publike prej 81m². Keto janë ne kufij njëra me tjetrën, sipas një komisioni i cili themelohet posaçërisht për këtë punë dhe përbëhet prej gjeodeteve, ekonomisteve, juristeve dhe ata dalin ne terrene dhe bëjnë një raport dhe i rekomandojmë kuvendit. Pra kontrollojnë tipin, klasën, vlerën dhe propozojnë pastaj kuvendit që kjo te këmbëhet një me një. Pra bëhet fjalë për zonë kadastrale ne qytet dhe qëllimi është që t hapim rrugë aty pasi që është rrugë aty me shume se 100 vjet por ne po dëshirojmë me rregullu këtë problematikë që edhe pronari privat por edhe ne si shtet me kërkuar te drejtat tona karshi pronarëve nëse

planifikojnë me ndërtua aty që me u pajisë me leje dhe me vendime tjera përcjellëse. Ftoj anëtarët e KPF-së që të miratojnë propozimin për marrjen e pëlqimit për këmbim të pronës publike me pronë private.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë nëse nuk ka dikush diçka rreth kësaj pike, konstatojmë se kalon për kuvend pika e parë shtesë. Kalojmë në pikën e dytë shtesë:

12. Kërkesë për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatshkurtër në zonën kadastrale në Rahovec.

Kryesuesi – Në mungesë të materialit për sot, jemi dakorduar që për mbledhje të kuvendit ta kemi materialin.

Artan Asllani – Bëhet fjalë për një zonë kadastrale e cila gjendet në Zoqisht, sipas kërkesave të personave qofshin fizik apo juridik, në i trajtojmë ato dhe i qesim me var aprovimin nga ana e KPF-së apo asamblesë së Komunës së Rahovecit.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, për mbledhje të kuvendit ta kemi materialin të kompletuar. Të nderuar kolegë kuvendarë, faleminderit për kontributin e dhënë dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi,

Agim Hoti

